**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER MIRANDA F. XHEMALÇE**
**ADRESA Bulevardi "Zhan D'Ark", Pallati 21/1, Shkalla 1, Apartamenti 1**
**TEL: 682044339**

# KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 348** **Nr. koleksioni: 92/**

**Tirane më 03/02/2021**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A202105327000879429l

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë

A2021053270008794291

**KONTRATË DHURIMI**
**E KUOTAVE TË SHOQËRISË TREGTARE**

Në Tiranë, sot më datë 03 **/02/2021,** përpara meje noteres publike **Miranda F. Xhemalçe**, anëtare e Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendnore Tiranë, me zyrë noteriale në adresën Bulevardi "Zhan D`Ark", Pallati 21/1, Shkalla 1, Apartamenti 1, u paraqitën personalisht:

**Dhuruesi**:
**Z. Ramiz Zekaj**, atësia Mustaf, lindur më datë 10/2/1965 në Radovc, Kosovë, banues në adresën Rruga "Irfan Tomini", Nd. 098, Njësia Administrative nr. 5, Njësia Bashkiake nr. 5 Tiranë, me gjendje civile "i martuar", madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga Letërnjoftimi ID me numër personal **G50210232Q**.

**Dhënës i pëlqimit:**
**Znj. Ndriçime Zekaj**, atësia Mynir, lindur më datë 26/7/1975 në Tiranë, banuese në adresën Rruga "Irfan Tomini", Nd. 098, Njësia Administrative nr. 5, Njësia Bashkiake nr. 5 Tiranë, me gjendje civile "e martuar", madhore, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga Letërnjoftimi ID me numër personal **H55726123S**.

**Pranuesi i dhurimit (Përfituesi):**
**Znj. Sumeja Zekaj**, atësia Ramiz, lindur më datë 11/1/1996 në Tiranë, banuese në adresën Rruga "Irfan Tomini", Nd. 098, Njësia Administrative nr. 5, Njësia Bashkiake nr. 5 Tiranë, me gjendje civile "beqare", madhore, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga Letërnjoftimi ID me numër personal **J65111041E**.

**Baza Ligjore:**
Neni 761, neni 764 (paragrafi i tretë) i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë
Neni 62, pika 1, gërma ""ll", Neni 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "*Për Noterinë*"
Neni 73, pika 1, gërma "ç", pika 2 i Ligjit nr. 9901, datë 14/4/2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*".

**Rrethanat për hartimin e aktit noterial:**
Dhuruesi Z. Ramiz Zekaj është ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë tregtare "**Media Kontakt" sh.p.k,** të regjistruar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, më datë 12.09.2003, nëpërmjet Vendimit nr. 30212, ku përcaktohej objekti i veprimtarisë në fushën e transmetimit për radio e televizion lokal, botim dhe tregëtim i mjeteve teknike audiovizive, librave, gazetave, revistave etj. Gjithashtu shoqëria është pajisur me certifikatë më datë 23/1/2004, me numër identifikimi (NIPT) K41323005T.
Z. Ramiz Zekaj është Administrator i shoqërisë, për periudhën 19/9/2003 – 18/7/2024, gjithashtu është zotërues i 6.200,00 kuotave, me vlerë nominale 1.000,00 për kuotë, me pjesëmarrje 100 %, pra zotërues i plotë dhe i vetëm i kuotave të shoqërisë "Media Kontakt" sh.p.k.

A20210532700008794291

Dhuruesi dhe pranuesja e dhurimit (përfituesja) kanë shprehur vullnetin e tyre për të krijuar këtë marrëdhënie kontraktore, për të cilën jepet edhe pëlqimi i bashkëshortes së dhuruesit. Unë noterja, pasi verifikova identitetin e palëve, vijoj me hartimin e Kontratës së Dhurimit me përmbajtje si më poshtë vijon:

**Neni 1**
**Objekti**

Objekti i kësaj kontrate është kalimi nëpërmjet dhurimit i të gjitha kuotave të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Media Kontakt" nga ana e dhuruesit Z. Ramiz Zekaj, në cilësinë e Ortakut të Vetëm dhe Administratorit, në favor të pranueses së dhurimit (përfitueses) Znj. Sumeja Zekaj, pa kundërshpërblim.

**Neni 2**
**Kalimi i të drejtës së pronësisë**

Palët janë dakord për kalimin e kuotave nga dhuruesi tek përfituesja, e cila, me plotësimin e kushteve ligjore për fitimin e kuotave, do të jetë zotëruesja e vetme e kuotave të shoqërisë "Media Kontakt" sh.p.k, pra pronarja e ligjshme.

**Neni 3**
**Deklarime dhe garanci**

Dhuruesi Z. Ramiz Zekaj deklaron dhe siguron pranuesen e dhurimit se:

- Shoqëria "Media Kontakt" sh.p.k është një shoqëri e themeluar dhe e regjistruar rregullisht dhe e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Statutin dhe dispozitat ligjore në fuqi;
- Shoqëria "Media Kontakt" sh.p.k nuk është në proces falimentimi apo likujdimi;
- Ortaku i Vetëm është pronar i ligjshëm i kuotave dhe ka titull të plotë pronësie;
- Kuotat e dhuruara janë të lira nga çdo barrë siguruese, pengesë, pretendime të të tretëve, kufizime apo pengesa ligjore. Nuk ekziston asnjë garanci apo kontratë shitje kuotash, në lidhje me kuotat e dhuruara;
- Kapitali i shoqërisë është shlyer rregullisht dhe nuk ka detyrime të papërmbushura apo të shkelura në lidhje me shlyerjen e kapitalit.

Përfituesja Znj. Sumeja Zekaj deklaron dhe siguron dhuruesin se:

- Ka të gjithë aftësitë juridike për të nënshkruar këtë kontratë dhe nuk ka pengesa ligjore që do të cënonin aftësinë e saj për të nënshkruar.
- Nuk ka asnjë fakt, rrethanë apo informacion, i cili mund të cënojë aftësinë e saj për të ushtruar të drejtat dhe për të zbatuar detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotave të kaluar nëpërmjet dhurimit.

**Neni 4**
**E drejta e parablerjes**

Në rast se kuotat e kaluara nëpërmjet kësaj kontrate dhurimi mund të jenë në të ardhshme objekt i shitjes/kalimit/dhurimit/transferimit tek palë të treta, përfituesja do të rezervojë të drejtën e parablerjes ndaj dhuruesit. Kjo nënkupton se përpara kontraktimit me persona të tretë, përfituesja, e cila do të jetë zotëruesja e vetme e kuotave, do të njoftojë fillimisht dhuruesin, në cilësinë e zotëruesit të mëparshëm të kuotave, për të shfrytëzuar të drejtën e parablerjes. Në rast se ky i fundit

A2021053270008794291

nuk dëshiron të përfitojë, do t'i komunikojë refuzimin e tij zotërueses së kuotave.

**Neni 5**
**Të ndryshme**

Palët bien dakord që do të zbatojnë me regorizitet detyrimet e tyre ligjore me nënshkrimin e këtij dokumenti.

Kjo kontratë dhurimi zëvendëson të gjitha marrëveshjet dhe rregullimet e mëparshme, verbale apo të shkruara, nëpërmjet palëve.

Në rast se ndonjë prej parashikimeve të kësaj kontrate konsiderohet e pavlefshme apo e pazbatueshme, palët do të bëjnë përpjekje për modifikim në minimumin e nevojshëm për ta kthyer të vlefshme apo të zbatueshme dhe nëse kjo nuk arrihet, parashikimi kontraktor do të menjanohet dhe kontrata do të jetë e vlefshme në tërësinë e saj.

Kontrata e dhurimit, si dhe pasoja e zbatimit të saj, rregullohet, interpretohen dhe zbatohen në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Çdo konflikt, ndryshim, mosmarrëveshje apo pretendim, që ka lindur për shkak të kësaj marrëveshje do të zgjidhet në mënyrë miqësore mes palëve, në rast të kundërt, do të trajtohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për sa më sipër, hartohet ky akt noterial nga unë noterja, në bazë të vullnetit të lirë, të plotë dhe të pavesuar të personave të paraqitur, si dhe në mbështetje të deklarimeve të tyre, të cilëve ju lexua përmbajtja e aktit dhe ju shpjeguan efektet ligjore të tij, dhe pasi deklaruan se e kanë kuptuar dhe pranuar, e nënshkruajnë atë rregullisht në praninë time. Unë noterja e vërtetoj sipas ligjit.

Bashkëlidhur, gjendet dokumentacioni i mëposhtëm:

- *Kopje e mjeteve të identifikimit të palëve*
- *Kopje e Ekstraktit Historik të Shoqërisë "Media Kontakt" sh.p.k, nxjerrë nga sistemi elektronik i QKB-së*
- *Kopje e përgjigjes së Regjistrit të Barrëve Siguruese*

Ky akt noterial përbëhet nga 3 (tre) faqe dhe lëshohet në 3 (tre) kopje origjinale me fuqi të njëjtë juridike, ku njëra prej tyre mbahet në arkivën e Zyrës Noteriale dhe dy kopje u dorëzohen palëve kontraktore.

*(Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij akti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme).*

**Dhurues** | **Pranues i Dhurimit**

**Dhënës i Pëlqimit**

**NOTERE**

**MIRANDA F. XHEMALÇE**

NOTERE
MIRANDA XHEMALÇE
TIRANË-ALBANIA

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

RBS
# Regjistri i Barrëve Siguruese

## REZULTATET E KËRKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te Kerkimit: | D-20210129162538639 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 29.01.2021 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 4:25:38PM |
| Lloji i Kerkimit: | |
| Numri i Dokumentit: | D-400-224-2017 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

Elza Kernai

RAMIZ MUSTAF ZEKAJ
MEDIA KONTAKT SH.P.K.

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANË - ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

# EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | K41323005T | |
| 2. Data e Regjistrimit | 20/01/2004 | |
| 3. Emri i Subjektit | MEDIA KONTAKT | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 19/09/2003 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 19/09/2003 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Tirane TIRANE FADIL RADA PALL RI PR. ATSH K 5 | |
| 8. Kapitali | 6.200.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 6.200,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Veprimtari e transmetim per radio e televizion lokal, botim dhe tregtim te mjeteve teknike audiovizive , te librave , gazetave , revistave etj | |
| 10. Administratori/ët | Ramiz Zekaj | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 19/09/2003 | Deri: 18/07/2024 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Ortakët | RamizZekaj | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 6.200.000,00 | Natyre: |
| 12.2 Numri i pjesëve | 6.200,00 | |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 100,00 | |
| - *Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse* | | |

Kopje nga web

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

| | |
|---|---|
| *zotëron kuotën si përfaqësues)* | |
| 13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | |
| 14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: MEDIA KONTAKT<br>E-Mail: sumejazekaj@gmail.com<br>Telefon: 0682025776 |
| 15. Statusi: | Aktiv |

Lista e Dokumenteve:

Regjistrimi Fillestar: CN-080618-09-07

## HISTORIKU I REGJISTRIMIT

| Data e regjistrimit | Ndryshimi i te dhenave te regjistruara |
|---|---|
| 1. 12/09 /2003 | Numri i Vendimit:30212, Gjykata:Tirane<br>Data e regjistrimit: 12.09.2003; Emri i subjektit: "Media Kontakt"; Forma ligjore: shpk; Data e themelimit: 10.09.2003; Kohezgjatja: mbi 10 vjet; Kapitali themeltar: 100.000 lekë; Selia: Rruga "Fadil Rada" (pranë A.T.SH), Tiranë; Objekti: Veprimtari e transmetim për radio e televizion lokal; botim dhe tregëtim i mjeteve teknike, audiovizive, librave, gazetave, revistave; Perfaqesuesi ligjor: Ramiz Zekaj; Ortaket:Ramiz Zekaj;<br><br>Lista e Dokumenteve:<br>R 34 Nr-27-EK-erjoni-12-12-20070012.pdf |
| 2. 27/10 /2003 | Numri i Vendimit:30212/1, Gjykata:Tirane<br>Me vendimin Nr.30212/1, datë 27.10.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur: Depozitimin pranë Regjistrit Tregtar të vendimit Nr.1, datë 22.10.2003 të ortakut të vetëm të shoqërisë në lidhje me pakësimin e objektit të aktivitetit të shoqërisë në fushën e Botimit dhe tregtimit të mjeteve teknike, audiovizive, librave, gazetave, revistave.<br><br>Lista e Dokumenteve:<br>R 34 Nr-27-EK-erjoni-12-12-20070012.pdf |
| 18/03/2008 | Numri i ceshtjes: CN-125172-03-08<br>Vlera e Kapitalit ishte *"100.000,00"* u be **"6.200.000,00"**<br>Numri i Aksioneve ishte *"100,00"* u be **"6.200,00"**<br>Data e Themelimit ishte *"10/09/2003"* u be **"19/09/2003"**<br>Telefon ishte *("")* u be **("0682025776")** |

Kopje nga aweb

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

| | |
|---|---|
| | Data e Themelimit ishte *"10/09/2003"* u be **"19/09/2003"**<br>Objekti ishte *(" Botimi dhe tregtimi i mjeteve teknike, audiovizive, librave, gazetave, revistave.")* u be **("Radio")**<br><br>Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme tek ortaket individ:<br>Kane ndryshuar te dhenat per *("Ramiz Zekaj")* , Vlera e Kontributit ishte *("100.000,00")* u be **("6.200.000,00")**<br>Kane ndryshuar te dhenat per *("Ramiz Zekaj")* , Numri i aksioneve ishte *("100,00")* u be **("6.200,00")**<br><br>***Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme tek administratoret:***<br>***Kane ndryshuar te dhenat per administratorin: ("Ramiz Zekaj") , Nga Data ishte ("10/09/2003") u be ("19/09/2003")***<br><br>Lista e Dokumenteve:<br>Akti i emerimit te organeve te shoqerise, nese nuk perfshihet ne aktet e tjera<br>Akti i ekspertimit te ekspertit vleresues te licensuar per pagesen e kapitalit ne natyre<br>Bilanci vjetor<br>Dokumenti i autorizimit |
| 26/08/2008 | Numri i ceshtjes: CN-166526-08-08 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE)<br><br>Lista e Dokumenteve:<br>Anekset e pasqyrave financiare, që përmbajnë një paraqitje të metodave kontabël, si dhe materialin tjetër shpjegues<br>Raporte administrimi (nëse ka)<br>Bilanci Kontabël<br>Pasqyra e ardhurave dhe të shpenzimeve<br>Pasqyra e rrjedhjes së parasë (cash flow)<br>Pasqyra e ndryshimeve në kapitalet e veta |
| 06/08/2014 | Numri i ceshtjes: CN-565631-07-14<br>Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitim i vendimit nr.2 dt.18.07.2014, ku u vendos: Miratimi i statutit. -Depozitim i statutit në përshtatje me ligjin 9901.<br>Objekti ishte *("Radio")* u be **("Veprimtari e transmetim per radio e televizion lokal, botim dhe tregtim te mjeteve teknike audiovizive , te librave , gazetave , revistave etj")** |

Kopje nga web

| | |
|---|---|
| | ***Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme tek administratoret:***<br>***Kane ndryshuar te dhenat per administratorin: ("Ramiz Zekaj") ,***<br>***Kohëzgjatja ishte ("") u be ("18/07/2019")***<br><br>Lista e Dokumenteve:<br>Statuti (nese eshte hartuar si dokument i ndryshem nga akti i themelimit)<br>Vendim i asamblese se pergjithshme |
| 08/08/2014 | Numri i ceshtjes: CN-599646-08-14 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE)<br><br>Lista e Dokumenteve:<br>Akti i miratimit te bilancit nga asambleja subjektit, ose nga individi tregtar)<br>Bilanci Kontabël<br>Dokumenti i autorizimit |
| 02/12/2014 | Numri i ceshtjes: CN-734963-11-14<br>Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i kërkesës së administratorit të shoqërisë, datë 26.11.2014, ku është kërkuar: Hapje adrese dytësore.<br><br>Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme ne Adresat e Aktivitetit:<br>eshte Shtuar Adresa: "**Tirane; TIRANE; Tirane; ; TIRANE; Njesia Bashkiake Nr.2, Rruga "Elbasanit 1000", Pallati Nr.87/2, Shkalla Nr.1, Kati Nr.2;** "<br><br>Lista e Dokumenteve:<br>Vendim i asamblese se pergjithshme<br>Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar) |
| 10/02/2015 | Numri i ceshtjes: CN-862329-02-15 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE)<br>Arsyet e hapjes se ceshtjes: Dorezim i bilancit te vitit 2012<br><br>Lista e Dokumenteve:<br>Bilanci Kontabël |

Kopje nga web

| | |
|---|---|
| | |
| 02/03/2015 | Numri i ceshtjes: CN-897145-02-15<br>Arsyet e hapjes se ceshtjes: Saktesimi i kodit ekonomit (NVE).<br><br>Lista e Dokumenteve:<br>Dokumenti i autorizimit<br>Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar) |
| 03/07/2015 | Numri i ceshtjes: CN-131682-07-15 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE)<br>Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitim bilanci 2011<br><br>Lista e Dokumenteve:<br>Akti i miratimit te bilancit nga asambleja subjektit, ose nga individi tregtar)<br>Anekset e pasqyrave financiare, që përmbajnë një paraqitje të metodave kontabël, si dhe materialin tjetër shpjegues<br>Bilanci Kontabël |
| 01/08/2015 | Numri i ceshtjes: CN-183885-07-15 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE)<br>Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i pasqyrave financiare te vitit ushtrimor 2014.<br><br>Lista e Dokumenteve:<br>Bilanci Kontabël<br>Akti i miratimit te bilancit nga asambleja subjektit, ose nga individi tregtar) |
| 25/07/2016 | Numri i ceshtjes: CN-841330-07-16 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE)<br>Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i pasqyrave financiare te vitit 2015.<br><br>Lista e Dokumenteve:<br>Bilanci Kontabël<br>Akti i miratimit te bilancit nga asambleja subjektit, ose nga individi tregtar) |
| 29/08/2016 | Numri i ceshtjes: CN-901925-08-16 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA |

Kopje nga web

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

| | |
|---|---|
| | FINANCIARE)<br>Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitim Bilanci 2009 |
| 28/09/2016 | Numri i ceshtjes: CN-954051-09-16 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE)<br>Arsyet e hapjes se ceshtjes: Bilanci 2010<br><br>Lista e Dokumenteve:<br>Bilanci Kontabël<br>Akti i miratimit te bilancit nga asambleja subjektit, ose nga individi tregtar) |
| 14/10/2016 | Numri i ceshtjes: CN-985800-10-16 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE)<br>Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitim bilanci 2008<br><br>Lista e Dokumenteve:<br>Bilanci Kontabël<br>Raporte administrimi (nëse ka) |
| 30/06/2017 | Numri i ceshtjes: CN-352997-06-17 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE)<br>Arsyet e hapjes se ceshtjes: Subjekti ka depozituar pasqyrat financiare te vitit 2016<br><br>Lista e Dokumenteve:<br>Bilanci Kontabël<br>Akti i miratimit te bilancit nga asambleja subjektit, ose nga individi tregtar) |
| 18/08/2017 | Numri i ceshtjes: CN-429672-08-17<br>Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i Vendimit të ortakut të vetëm të shoqërisë, datë 09.08.2017, ku është vendosur: Mbyllja e adresës dytësore të ushtrimit të aktivitetit.<br><br>Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme ne Adresat e Aktivitetit:<br>eshte Hequr Adresa: "*Tirane; TIRANE; Tirane; ; TIRANE; Njesia Bashkiake Nr.2, Rruga "Elbasanit 1000", Pallati Nr.87/2, Shkalla Nr.1, Kati Nr.2;* " |

Kopje nga web

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

| | |
|---|---|
| | Lista e Dokumenteve:<br>Dokumenti i autorizimit<br>Vendim i asamblese se pergjithshme |
| 27/06/2018 | Numri i ceshtjes: CN-836539-06-18 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE)<br>Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i Pasqyrave Financiare të vitit 2017<br><br>Lista e Dokumenteve:<br>Akti i miratimit te bilancit nga asambleja subjektit, ose nga individi tregtar)<br>Bilanci Kontabël |
| 24/06/2019 | Numri i ceshtjes: CN-238169-06-19 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE)<br>Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i pasqyrave financiare te vitit 2018.<br><br>Lista e Dokumenteve:<br>MEDIA KONTAKT Pasqyra e performancës (pasqyra e të ardhurave dhe të shpenzimeve) sipas natyres.xlsx<br>MEDIA KONTAKT VENDIMI ORTAKUT 2018.PDF<br>MEDIA KONTAKT Pasqyra e pozicionit financiar.xlsx<br>MEDIA KONTAKT BILANCI 2018.pdf |
| 26/07/2019 | Numri i ceshtjes: CN-284623-07-19<br>Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i vendimit, datë 18.07.2019 ku është vendosur: Riemërim administratori.<br>E-Mail ishte *("")* u be **("sumejazekaj@gmail.com")**<br><br>***Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme tek administratoret:***<br>***Kane ndryshuar te dhenat per administratorin: ("Ramiz Zekaj") ,***<br>***Kohëzgjatja ishte ("18/07/2019") u be ("18/07/2024")***<br><br>Lista e Dokumenteve:<br>Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)<br>Vendim i asamblese se pergjithshme |

Kopje nga web

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

| | |
|---|---|
| 17/07/2020 | Numri i ceshtjes: CN-546233-07-20 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE)<br>Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i Pasqyrave Financiare 2019.<br><br>Lista e Dokumenteve:<br>vendimi Media Kontakt.pdf<br>Pasqyra e pozicionit financiar.xlsx<br>shenime shpjegese Media Kontakt shpk 2019.pdf<br>Pasqyra e performancës (pasqyra e të ardhurave dhe të shpenzimeve) sipas natyres.xlsx |

Datë: 29/01/2021

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga web